ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-26-6138-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material harxhues për qëllime të diagnostikës Mikrobiologjike të Tuberkulozës në Kosovë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Flamur Isufi B.I.**
NUI	**810475120**
Adresa	**Vasil Andoni 10**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+383 44503250**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**FLAMUR ISUFI**
Adresa elektronike	**flamur@era-med.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**29.10.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 4. GenoScreen Deeplex& Myc-TB Combo Kit, or equivalent for targeted next generation sequencing for identification of Mycobacterium tuberculosis complex (MTBC) strains, mycobacterial species identification, genotyping, and prediction of drug resistance mutations of MTBC strains.

Loti 4

Aktiviteti i prokurimit: "Furnizim me material harxhues për qëllime të diagnostikës Mikrobiologjike të Tuberkulozës në Kosovë", nr. 206-26-6138-1-1-1, Loti 4 (GenoScreen Deeplex® Myc-TB Combo Kit, or equivalent …). Kriteri: çmimi më i ulët.

Autoriteti Kontraktues (AK): Ministria e Shëndetësisë – Divizioni i Prokurimit.

Operatori ekonomik i rekomanduar: Interlab SH.P.K., nr. fiskal 601678008.

Vendimet që kundërshtohen:

1. Vendimi i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit i datës 21.10.2026, me të cilin u refuzua kërkesa për rishqyrtim e Ankuesit e datës 09.10.2026;

2. Njoftimi mbi vendimin e AK (B58) i datës 06.10.2026, për Lotin 4.

I. Faktet dhe kronologjia

1. Më 28.07.2026 u publikua njoftimi për kontratë. Më 07.09.2026 u hapën tenderët. Për Lotin 4 u dorëzuan vetëm dy oferta: Interlab SH.P.K. me 32,161.02 € pa TVSh / 37,950.00 € me TVSh dhe Ankuesi me 37,101.69 € pa TVSh / 43,780.00 € me TVSh (procesverbali B12).

2. Më 06.10.2026 AK rekomandoi për kontratë Interlab SH.P.K. Me letrën e të njëjtës datë AK e njoftoi Ankuesin se oferta e tij nuk u shpërblye "ngase tenderi juaj nuk ka qen tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat". Pra oferta e Ankuesit u konsiderua e përgjegjshme.

3. Më 07.10.2026 Ankuesi pati qasje në ofertën e Interlab SH.P.K. dhe më 09.10.2026 parashtroi kërkesë për rishqyrtim lidhur me pozicionin 2 të Lotit 4, ku dosja e tenderit kërkon "MS-102-2002 - MiSeq Reagent Kit v2 (300- cycles) or equivalent".

4. Më 21.10.2026 AK e refuzoi kërkesën. Ankuesi e ka pranuar vendimin më 21.10.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ankuesi është ofertues në Lotin 4, me ofertë të vlerësuar si të përgjegjshme dhe të renditur e dyta, prandaj ka interes juridik sipas LPP-së. Ankuesi ka zhvilluar procedurën paraprake sipas nenit 108/A të LPP-së. Ankesa parashtrohet brenda dhjetë (10) ditëve sipas nenit 109.2 të LPP-së dhe nenit 64.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (në tekstin e mëtejmë: RRPP), siç e udhëzon edhe këshilla juridike e vendimit të AK. Tarifa e ankesës është paguar në shumën [380.00] €.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenet 7, 59, 60, 61 dhe 108/A të LPP-së;
nenet 38, 40 dhe 41 të RRPP-së, e ndryshuar me Rregulloren nr. 002/2024.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Baza I – Vendimi i AK është në kundërshtim me vetveten: pretendimet konstatohen "të bazuara", ndërsa kërkesa refuzohet "si e pa bazuar" (neni 108/A i LPP-së)

Në faqen 4 të vendimit, AK shprehet: "E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund te konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore janë te bazuara dhe qe nuk e ndryshojnë vendimin e AK." Ndërkaq, pika 1 e dispozitivit thotë: "Refuzohet, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim".

Një pretendim që AK e konstaton të bazuar nuk mund të refuzohet si i pabazuar. AK nuk shpjegon se si pretendime të bazuara për përgjegjshmërinë e ofertës "nuk e ndryshojnë vendimin", kur dhënia e kontratës, sipas nenit 60 të LPP-së, varet pikërisht nga përgjegjshmëria.

Për më tepër, ZPP shprehet se Ankuesi "nuk ka te drejte ne këtë ankese" (f. 6), duke përdorur gjuhë mospranueshmërie, ndërsa dispozitivi e shqyrton dhe e refuzon kërkesën në meritë. AK vetë, me letrën e 06.10.2026, e njoftoi Ankuesin për të drejtën e kërkesës sipas nenit 108/A. Edhe hyrja e vendimit i referohet një kërkese "të datës 11.08.2026", që nuk ekziston, ndërsa kërkesa e Ankuesit është e 09.10.2026.

Këto mospërputhje e bëjnë vendimin të paarsyetuar në kuptim të nenit 108/A të LPP-së dhe e pamundësojnë kontrollin e ligjshmërisë së tij.

Baza II – ZPP shpërfilli konstatimet dhe rekomandimin e Njësisë së Kërkesës, pa e verifikuar produktin e ofruar (neni 59 i LPP-së, neni 40 i RRPP-së)

ZPP pranon në vendim se pretendimet e Ankuesit "jane shqyrtuar edhe nga komisioni vleresues – Njesia e Kerkeses" (f. 4). Ky organ teknik konstatoi:

– se MiSeq Reagent Kit v2 (MS-102-2002) dhe MiSeq Reagent Kit v2 Nano (MS-103-1001) "janë dy produkte të ndryshme", me output rreth 4.5–5.1 Gb kundrejt rreth 300 Mb dhe rreth 24–30 milionë kundrejt rreth 2 milionë lexime paired-end (f. 4);

– se kiti Nano "nuk mund të konsiderohet automatikisht ekuivalent teknik" (f. 5);

– se, nëse oferta nuk e përcakton qartë produktin, "ekziston paqartësi teknike që duhet të shqyrtohet nga Autoriteti Kontraktues" (f. 5);

– dhe rekomandoi: "që Autoriteti Kontraktues të verifikojë dokumentacionin origjinal të ofertës së OE INTERLAB SH.P.K. dhe të përcaktojë nëse produkti i ofruar është konkretisht MiSeq Reagent Kit v2, me numër katalogu MS-102-2002, ose një produkt tjetër" (f. 5).

Vendimi nuk tregon që ky verifikim është bërë dhe nuk përmban asnjë konstatim se cili produkt është ofruar. ZPP nuk kundërshton asnjë nga gjetjet teknike; ai thjesht i anashkalon. Një vlerësim që nuk përcakton se çfarë është ofruar nuk është ekzaminim dhe vlerësim i tenderit në kuptim të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40 të RRPP-së.

Baza III – ZPP e interpreton klauzolën "or equivalent" në kundërshtim me hartuesin e specifikimit (nenet 59 dhe 60 të LPP-së)

Arsyeja kryesore e refuzimit është: "ju nuk keni te drejte ne këtë ankese, meqenëse ne specifikimin Teknik te hartuar nga IKSHPK si Njësi e Kërkesës, te produkti nr. 2 qe ju e keni kontestuar, është lejuar "or equivalent"" (f. 6).

Por e njëjta IKSHPK, që sipas ZPP-së e hartoi specifikimin, konstaton në të njëjtin

vendim se kiti Nano nuk është automatikisht ekuivalent dhe se “Ekuivalenca duhet të vlerësohet në raport me të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit” (f. 5). Klauzola “ose ekuivalent” lejon vetëm produkte ekuivalente dhe e detyron AK të verifikojë ekuivalencën. Ajo nuk e çliron AK nga detyrimi për të vërtetuar se çfarë është ofruar, as nuk e bën të pranueshëm një produkt që vetë njësia teknike e konsideron joekuivalent.

Baza IV – Oferta e Interlab nuk e identifikon me siguri produktin e ofruar; AK nuk kërkoi sqarim (neni 60.1 i LPP-së, neni 38 i RRPP-së)

AK e mbron ofertën me Përshkrimin e Çmimeve, të cilin e riprodhon në faqen 6 të vendimit. Pikërisht ky dokument e konfirmon paqartësinë. Për pozicionin 2, Interlab ka shënuar:

– si OEM#: “MS-102-202”, numër që nuk ekziston në katalogun e Illumina (numri i saktë është MS-102-2002);

– si përshkrim: “MiSeq Reagent Kit v2 (300-cycles) or equivalent”;

– si origjinë: “Illumina Inc. USA (or equivalent)”.

Oferta, pra, nuk përmban numër të vlefshëm katalogu dhe nuk e angazhon ofertuesin as për produkt, as për prodhues konkret. Dokumentacioni teknik i bashkëngjitur për këtë pozicion (Broshura “Art. 2”, Illumina M-GL-00006 v4.0) paraqet në tabelën “Ordering information” (f. 5) si “MiSeq Reagent Kit v2 (300-cycles) MS-102-2002”, ashtu edhe “MiSeq Reagent Nano Kit v2 (300-cycles) MS-103-1001”, të cilat [ishin të nënvizuara] në ofertë. Të dy kanë “300-cycles”, prandaj ky emërtim nuk e dallon produktin.

Deklarata e Interlab e 07.09.2026, në të cilën AK mbështetet (f. 6–7), është formulë e përgjithshme se produktet “i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara … në Aneksin 1”, pa emër produkti, kod apo prodhues. Nëse një deklaratë e tillë do të mjaftonte, vlerësimi teknik do të ishte i panevojshëm.

Në këto rrethana, AK kishte dy mundësi të ligjshme: të kërkonte sqarim nga ofertuesi sipas nenit 38 të RRPP-së, pa lejuar ndryshimin e ofertës, ose ta konstatonte ofertën si të papërgjegjshme sipas nenit 60.1 të LPP-së. AK nuk bëri asnjërën.

Baza V – AK e trajtoi si përparësi atë që njësia e saj teknike e konstatoi si shenjë rreziku; nuk kërkoi arsyetim të çmimit (neni 61 i LPP-së, neni 41 i RRPP-së)

Njësia e Kërkesës konstatoi se çmimi prej 800 € për njësi “përkon më tepër me nivelin e çmimit të MiSeq Reagent Kit v2 Nano” dhe se kjo “përbën një tregues shtesë se produkti i ofruar mund t’i referohet variantit Nano”, duke rekomanduar që çështja të trajtohet “duke kërkuar sqarime ose arsyetim kur plotësohen kushtet ligjore” (f. 5). ZPP, përkundrazi, e paraqet çmimin e ulët si meritë: “duke mundësuar ruajtjen e buxhetit te shtetit për rreth 6,000 euro” (f. 7).

Çmimi 800 € përfshin TVSh 18% (B12), pra çmimi neto është rreth 677.97 € për kit. Ankuesi dorëzoi çmim referues prej 2,109.03 $ për MS-102-2002 (kërkesa, f. 3); si orientim tjetër, lista publike e CEINGE (Napoli, 2022) jep 1,121.00 € për MS-102-2002 dhe 313.00 € për MS-103-1001. AK nuk e shqyrtoi asnjë nga këto dhe nuk kërkoi arsyetim me shkrim nga ofertuesi, siç parashihet në nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RRPP-së kur një tender ose një pozicion duket jo-normalisht i ulët. Ankuesi nuk pretendon se çmimi vetëm dëshmon ofrimin e kitit Nano, por që, së bashku me paqartësinë e ofertës, ai e detyronte AK të kërkonte sqarim para rekomandimit.

Baza VI – AK u mbështet në konsiderata që nuk parashihen në LPP dhe në dosjen e tenderit (nenet 7, 59 dhe 60 të LPP-së)

(a) Vlera e vogël e pozicionit. AK thekson se pozicioni 2 "është me vlere te vogël (3,200 euro)" (f. 6). LPP nuk njeh përjashtim nga përgjegjshmëria për pozicione me vlerë të vogël. Për më tepër, sipas Përshkrimit të Çmimeve të vetë Interlab, pozicioni 1 përfshin 4 kite Deeplex® Myc-TB me nga 48 mostra (33,400 €) dhe pozicioni 2 përfshin 4 kite MiSeq, pra një kit sekuencimi për çdo ekzekutim me 48 mostra., kiti sipas të dhënave në broshurën e Interlab standard jep rreth 24–30 milionë lexime për ekzekutim dhe kiti Nano rreth 2 milionë, që për 48 mostra do të thotë rreth 12–15 herë më pak lexime për mostër. Njësia e Kërkesës konfirmoi se kapaciteti ndikon në "numrin e mostrave për proces, thellësinë e sekuencimit" (f. 4). Pozicioni 2, pra, kushtëzon përdorimin e pozicionit 1.

(b) Kursimi i buxhetit. Kriteri i çmimit më të ulët zbatohet vetëm ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm (neni 60.1 i LPP-së). Kursimi nuk mund ta zëvendësojë vlerësimin e përgjegjshmërisë.

(c) Shpërndarja e kontratave ndërmjet kompanive. ZPP shkruan se ka vepruar edhe për të mundësuar "mundësinë edhe te kompanive tjera qe te shpërblehen me kontrate për IKSHPK" (f. 7). Kjo konsideratë nuk ekziston në dosjen e tenderit dhe as në LPP. Ajo bie ndesh me kriterin e çmimit më të ulët që ZPP e citon në të njëjtën fjali dhe me parimin e barazisë në trajtim sipas nenit 7 të LPP-së. Fakti që Ankuesi ka fituar lote të tjera të këtij aktiviteti nuk mund të ndikojë në vlerësimin e Lotit 4.

VI. Kërkesa

Ankuesi i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së:

1. Të aprovojë si të bazuar këtë ankesë;
2. Të anulojë vendimin e AK të datës 21.10.2026 dhe Njoftimin mbi vendimin e AK (B58) të datës 06.10.2026 për Lotin 4;
3. Ta refuzojë ofertën e OE Interlab SH.P.K. për Lotin 4 si të papërgjegjshme;
4. Të urdhërojë AK që kontratën për Lotin 4 t'ia japë Ankuesit, N.T.P ERAMED – Flamur Isufi B.I., si operatori i vetëm ekonomik me ofertë të përgjegjshme në këtë lot;
5. Të urdhërojë kthimin e tarifës së ankesës sipas nenit 118 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Në Lotin 4 janë dorëzuar vetëm dy oferta. Oferta e Interlab SH.P.K. është e papërgjegjshme, sepse nuk e identifikon me siguri produktin e ofruar në pozicionin 2 dhe nuk dëshmon se ai është ekuivalent me MS-102-2002. Oferta e Ankuesit (43,780.00 €) është vlerësuar nga AK si e përgjegjshme, prandaj Ankuesi është

operatori i vetëm ekonomik me ofertë të përgjegjshme në këtë lot dhe duhet të shpallet fitues. Shkeljet e mësipërme e kanë privuar Ankuesin drejtpërdrejt nga kontrata për Lotin 4.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*